



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Rrjeti Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 23.02.2021, ora 13:00

**Drejton mbledhjen:**

**Vasilika Hysi – nënkryetare e Kuvendit**

**Rendi i ditës:** Diskutimi dhe miratimi i Raportit të Monitorimit të SELP për periudhën janar-dhjetor 2020.

**Marrin pjesë:** Vasilika Hysi, Ardiana Hala, Blerta Xhako, Urim Bajrami, Eda Noçka, Tatjana Janku, Vildan Kaloshi, Erzen Tola.

**Mungojnë:** Evis Qaja, Anisa Metalla, Ilir Rusi, Iris Aliaj.

## HAPET MBLEDHJA

**Vasilika Hysi** – Përshëndetje të nderuar anëtarë të Komitetit Drejtues të Rrjetit për Edukimin Ligjor të Publikut!

Uroj që të gjitha familjet tuaja të jenë mirë në këtë periudhë të vështirë të shkaktuar nga pandemia!

Njëkohësisht më lejoni që fillimisht t'ju falënderoj për angazhimin dhe që gjetët kohë për të qenë së bashku sot në këtë takim *online*.

Sikurse ju jeni në dijeni Strategjia e Edukimit Ligjor miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 47 të vitit 2019 ka pasur si një element të saj miratimin e planit të veprimit nga Ministria e Drejtësisë. Ky plan është miratuar, ka hyrë në fuqi dhe institucionet, pjesë e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut kanë depozituar pranë Ministrisë së Drejtësisë raportet përkatëse.

Për dijeni dhe për publikun e gjerë që na ndjek, SELP-ja është një nga dokumentet strategjike të hartuar në kuadër të reformës në drejtësi dhe ka një komponent shumë të rëndësishëm, informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për liritë dhe të drejtat e tij, por edhe për mekanizmat e gëzimit të këtyre të drejtave. Një nga 7 shtyllat e reformës në drejtësi ka qenë dhe mbetet edukimi ligjor.

Sot ne kemi marrë zyrtarisht raportin e depozituar nga Ministria e Drejtësisë lidhur me zbatimin e SELP-së dhe të planit të veprimit për periudhën janar-dhjetor 2020. Sipas strategjisë ju jeni Komiteti Drejtues i rrjetit, keni të drejtën të parashtroni pyetje për të diskutuar dhe së bashku dhe për ta miratuar raportin që do të prezantohet nga Ministria e Drejtësisë. Më pas, me miratimin e këtij raporti, do të vihet në dijeni Kryetari i Kuvendit dhe një kopje e raportit do t'i përcillet Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Bordi Këshillimor i rrjetit dhe i komitetit ka të drejtë të japë mendime dhe sugjerime për përmirësimin e raportimit nga institucionet në lidhje me zbatimin e planit të veprimit dhe strategjisë, por njëkohësisht edhe ne, si pjesë e këtij komiteti, kemi detyrimin që gjatë shqyrtimit të raportit të bëjmë edhe sugjerime për (*nuk dëgjohet*) e zbatimit të tij dhe për ta riparë nëse aktivitetet e planifikuara në kuadër të 4 objektivave që përmban SELP-ja janë të përputhshme dhe në varësi të realizimit të këtyre objektivave për vitin që sot po analizojmë, të bëjmë rekomandimet përkatëse për institucione të përfshira në zbatimin e SELP-së dhe të planit të veprimit.

Pa humbur kohë unë do të doja t'ia kaloja fjalën zonjës Jaku, duke shprehur paraprakisht edhe falënderimet për angazhimin që në një kohë shumë të shkurtër, por edhe vështirësive të shkaktuara qoftë nga pandemia, edhe nga tërmeti, keni mundur të realizoni raportimin dhe dorëzimin e raportit brenda afateve ligjore në Kuvend.

Fjala është për ju, zonja Janku.

**Tatjana Janku** – Faleminderit, zonja Hysi!

Faleminderit të gjithëve që jeni pjesëmarrës në këtë takim! Uroj të jeni të gjithë mirë, ju dhe familjarët tuaj!

Sikundër e tha dhe zonja Hysi, Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për monitorimin e planit të veprimit të strategjisë së edukimit ligjor për publikun. Ne e kemi bërë të ditur këtë raport, e kemi publikuar edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, është miratuar në KDS në datën 10.2.2021, megjithatë unë po ju paraqes një përmbledhje të shkurtër të këtij raporti.

Strategjia për edukimin ligjor të publikut 2019-2023 është miratuar me vendimin nr.47, datë 18.4.2019, nga Kuvendi i Shqipërisë.

Plani i veprimit 20-23, në zbatim të SELP-it, është miratuar me vendimin nr.878, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave.

Vizioni i kësaj strategjie janë qytetarët e ndërgjegjësuar për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevoja specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.

Qëllimi i strategjisë është të rritë njohuritë për ligjin, duke promovuar respektimin e tij, me qëllim lehtësimin e marrëdhënieve qytetare me administratën, uljen e numrit të konflikteve ligjore, si dhe të rritë aksesin e qytetarëve në organin e drejtësisë dhe efikasitetin e gjykatave dhe organeve publike, duke shërbyer në forcimin e demokracisë.

Sikundër jeni në dijeni dhe e tha edhe zonja Hysi, strategjia për edukimin ligjor ka përcaktuar 4 objektiva strategjike të nivelit të lartë, të cilat janë: përmirësimi i organizimit dhe funksionimit institucional në ofrimin e ELP-it; garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitutional në nivel kombëtar, rajonal e vendor për realizimin e edukimit ligjor të publikut; sigurimi i performancës efektive dhe eficiente të institucioneve publike dhe të pavarura, medias e shoqërisë civile; ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.

Plani i veprimit për edukimin ligjor të publikut, siç e thashë dhe më sipër, i miratuar me vendimin nr.878, datë 11.11.2020, ka 28 masa të parashikuara, të detajuara në 79 aktivitete

ose nisma dhe iniciativa konkrete, 35 institucione përgjegjëse në rol udhëheqës dhe bashkëpunues, gjithashtu, janë dhe institucionet qendrore e vendore të pavarura, ku Ministria e Drejtësisë ka rolin e monitorimit të këtij plani veprimi, si dhe ministritë e linjës, njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion i përcaktuar në planin e veprimit si përgjegjës për zbatimin e tij.

Një risi në këtë strategji dhe në këtë plan veprimi është përfshirja proaktive e organizatave të shoqërisë civile, të cilat asistojnë të gjitha institucionet publike në kryerjen e veprimtarive dhe iniciativave, si një mekanizëm garantimi për realizimin e masave.

Gati 1/2-ta e masave do të mundësohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, të cilat, gjithashtu, kanë një rol asistues, zbatues, financues dhe monitorues.

Po bëj një përmbledhje për strukturën e raportit të monitorimit (kjo është strategjia e parë që monitorohet në bazë të formatit të IPSIS-it): është progresi i strategjisë për edukimin ligjor të publikut, ku janë kapitujt e shtyllat kryesore të këtij raporti monitorimi; progresi i lidhur me objektivat strategjike, objektivat specifike dhe masat, duke përfshirë dhe aktivitetet, gjithashtu dhe kapitulli IV i këtij raporti monitorimi ka mundësitë dhe hapat për t'u adresuar, si dhe konkluzione të cilat kanë dalë gjatë monitorimit.

Një përmbledhje fare të shkurtër për gjetjet e këtij raporti monitorimi, më gjerësisht dhe më hollësisht, janë të paraqitura në raport, të cilin e keni në dispozicion.

Në planin e veprimit 2020-2023 janë parashikuar në total 79 aktivitete, nga të cilat 31 aktivitete janë të zbatuara plotësisht ose 39%.

14 aktivitete janë zbatuar pjesërisht ose janë në proces zbatimi, të cilat zënë një vend prej 18%, kurse një aktivitet është i pazbatuar ose 1%, si dhe 17 aktivitete janë jashtë periudhës së raportimit ose 22%, të cilat janë aktivitete që do të zhvillohen në vitet në vijim. 6 aktivitete janë të raportuara nga institucionet përgjegjëse ose që zënë një total prej 20%.

Nga analiza për aktivitetet e raportuara rezulton se për vitin 2020 janë alokuar në total 527391,5 lekë nga buxheti i shtetit, si dhe 831626,5 lekë nga donatorët.

Sipas formatit IPSIS këto shuma janë të shprehura në mijë lekë.

Po ju bëj, gjithashtu, me dije se në formatin IPSIS janë të parashikuara vetëm tre stative të zbatimit të aktiviteteve, të masave dhe objektivave në përgjithësi, që janë të zbatuara, janë gjithë ato aktivitete dhe masat të cilat dalin nga mbledhja e këtyre aktiviteteve, që janë të raportuara të zbatuara nga institucionet përgjegjëse dhe bashkëpunuese, pjesërisht të zbatuara ose në proces. Do të thotë që gjatë periudhës së monitorimit të parashikuar për vitin 2020 ose edhe në vitet në vijim, këto aktivitete dhe masa nuk janë zbatuar pjesërisht, për shkak të ndryshme për të cilat jemi në dijeni, siç ka qenë periudha e pandemisë ose edhe e tërmetit, kur

një pjesë e institucioneve, fondet që kanë pasur të parashikuara për këto aktivitete kanë kaluar në gjëra të tjera për t'u zbatuar, që kanë qenë prioritete të qeverisë.

Një nga statutet e tjera është pas-zbatuar, që do të thotë se institucionet kanë pasur për të zbatuar aktivitete gjatë vitit 2020, por nuk kanë arritur t'i zbatojnë për shkaqet e tyre.

Gjithashtu, formati IPSIS nuk parashikon që gjatë monitorimit të planit të veprimit ka edhe aktivitete dhe masa të cilat janë jashtë periudhës së raportimit, por e merr si një të tërë. Ne kemi futur në raportin e monitorimit edhe një status tjetër, kur kemi analizuar masat, aktivitetet, objektivat strategjike dhe objektivat specifike, kemi futur edhe statusin “jashtë periudhës së raportimit” që do të thotë se janë të gjitha këto që përmenda më sipër, që nuk i përkasin vitit 2020.

Për këtë arsye, nga disa institucione ka pasur edhe pyetje se përse statusi i tyre është futuri pazbatuar dhe i paraportuar, vetëm për këtë arsye sepse trajtimi i masave dhe objektivave specifike dhe strategjike është llogaritur mbi mesataren e ponderuar. Për këtë arsye këtyre masa, ashtu siç e parashikon formati IPSIS, u është vendosur ky status. Siç e thamë, plani i veprimit ka parashikuar gjithsej 28 masa, nga këto 7 janë të zbatuara plotësisht ose 25% e totalit, 12 masa ose 43% janë zbatuar pjesërisht ose janë në proces zbatimi, 6 masa janë jashtë periudhës së raportimit që nuk i përkasin vitit 2020, periudha e cila është monitoruar, ose 21% e totalit dhe 6 masa janë të paraportuara nga institucionet përgjegjëse që përfshijnë një total prej 11%.

Përqindja ndaj totalit të objektivave specifike

Domethënë është bërë një analizë për objektivat specifike dhe dihet që janë 16. Nga këta 1 objektivi specifik është i zbatuar plotësisht, ose 6,3% e totalit, 12 objektiva specifike janë zbatuar pjesërisht ose janë në proces zbatimi, një total prej 17,5%, 2 objektiva specifike janë jashtë periudhës së raportimit, ose 12,5%, të cilat do të zhvillohen gjatë viteve në vijim dhe 1 objektivi specifik është i paraportuar nga institucionet përgjegjëse, që i bie 6,3%. Ky është statusi i zbatimit të objektivave strategjike. Duke analizuar të gjitha ato që thashë më sipër, aktivitetet, masat, objektivat specifike, të cilat janë në funksion të zbatimit të objektivave strategjike të kësaj strategjie, rezulton se për vitin 2020 objektivat strategjike për periudhën janar-dhjetor janë në shkallë zbatueshmërie të pjesshme, 50%. Rezultojnë të jenë të 4-ra këta objektiva, sepse janë në statusin “zbatuar pjesërisht ose që janë në proces zbatimi për vitet në vijim”.

Problematikat e hasura gjatë raportimit vjetor

Vihet re një problematikë shqetësuese, që është tejkalimi i afateve të raportimit nga institucionet përgjegjëse, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në hartimin e raporteve të monitorimit;

mosdërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar të aktiviteteve të parashikuara nga një pjesë e institucioneve, të cilat janë të pakta, por që ndikojnë në pasqyrimin joreal të kostove për zbatimin e strategjisë, sidomos për fondet e alokuara nga donatorët. Gjatë fazës së monitorimit është vënë re nevoja e një bashkëpunimi më të lartë i ministrive të linjës dhe kërkohet të raportojnë edhe për institucionet e tyre të varësisë, pasi shprehen se nuk janë institucione varësie, nuk duhet ta merrni informacionin nga ne, por nga këto institucione.

Problematikë e rëndësishme është cilësia e kontributeve, të cilat janë raportuar pjesërisht, ku shpesh janë rikthyer për t'u plotësuar sipas kërkesave dhe në përputhje me formatin IPSIS-it të planit të veprimit. Kemi pasur një bashkëveprim të mirë me një pjesë të madhe të institucioneve, ku pjesën më të rëndësishme kemi arritur ta bëjmë nëpërmjet bisedave telefonike, ku kemi ndarë shqetësimet e tyre dhe jemi mësuar bashkërisht se si të arrijmë të përmbushim, të plotësojmë formatin IPSIS, të cilin e pranojmë se është i ri, si për ne që e monitorojmë, ashtu edhe institucionet që japin kontributet.

Gjatë fazës së monitorimit është vënë re një numër i madh pikash kontakti, të cilat kanë raportuar për aktivitete të veçanta të planit të veprimit, duke mos u koordinuar brenda institucionit raportues, në mënyrë që të dërgohet pranë Ministrisë së Drejtësisë një raportim i plotë mbi të gjitha aktivitetet respektive të institucionit përgjegjës.

Një vështirësi e madhe, një problematikë e hasur, siç e kemi diskutuar dhe në takime të tjera, është plotësimi i hendekut të evidentuar midis pasaportës së indikatorëve dhe planit të veprimit, pasi ka institucione dhe subjekte, të cilat nuk janë përgjegjëse në plan veprimi, por rezultojnë përgjegjëse në pasaportën e indikatorit. Për këtë arsye, duke qenë edhe hera e parë e monitorimit, duke mos pasur as afate të vendosura, në këtë raport monitorimi, megjithëse ishte vjetor, ne nuk bëmë dot një matje dhe një analizë të matjes së indikatorëve, pasi pati edhe goxha institucione, të cilat nuk raportuan jo vetëm për pasaportën e indikatorëve, por as për aktivitetet në planin e veprimit.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet në lidhje me çfarë kemi vënë re në raportet e monitorimit:

-Të përmirësohet performanca e aktivitetit të institucioneve që raportojnë masa dhe aktivitete në proces zbatimi, të cilat janë ende për t'u zbatuar.

-Të ulet numri i masave dhe aktiviteteve që rezultojnë të pazbatuara.

-Të përmirësohet dhe të mundohemi të arrijmë të përmirësojmë bashkërisht metodologjinë IPSIS të raportimit të zbatimit të masave dhe të aktiviteteve për periudhën në zbatim.

-Të vijojë zbatimimi i masave në statusin e zbatuar pjesërisht ose në proces, sipas afateve të parashikuara.

-Të nisë me kohë zbatimimi i masave dhe aktiviteteve të parashikuara për periudhën në vijim. Tashmë ka filluar për vitin 2021, sidomos për ato aktivitete dhe masa, të cilat janë të parashikuara për t'u zhvilluar gjatë gjashtëmujorit të parë.

-Të tregohet kujdes për organizimin e punës dhe të proceseve përkatëse në lidhje me ecurinë e masave dhe të aktivitetit.

-Të sigurohen burimet e kapacitetet njerëzore, si dhe ekspertiza e nevojshme për kryerjen e tyre.

-Të garantohen burimet financiare të munguara, që ndikojnë në zbatueshmërinë e masave dhe të aktiviteteve, për ato masa dhe aktivitete ku ka një hendek financiar.

Të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm për masa dhe aktivitete, të cilat janë të përbashkëta. Nuk është vetëm një institucion përgjegjës për garantimin e atij aktiviteti dhe të atyre masave, të cilat janë të parashikuara.

-Të garantohet koordinim i mjaftueshëm për të shkëmbyer në mënyrë efektshme informacionin dhe për të zgjidhur problemet penguese, që mund të zgjidhen nga institucionet përgjegjësve dhe bashkëpunëtore.

Kjo ishte një përmbledhje e shkurtër e raportit të monitorimit. Në lidhje me çdo pyetje apo diskutim që mund të keni, ne jemi të hapur t'ju japim shpjegime, për aq sa kemi vënë re. E thamë edhe më parë, që është një format i ri, është një monitorim i parë me këtë format IPSIS, e ndoshta edhe ne kemi nevojë të mësojmë nga njëri-tjetri.

Ju faleminderit të gjithëve!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Janku, për prezantimin e përmbledhur dhe informues lidhur me Raportin Vjetor të Monitorimit të Strategjisë. Raporti është voluminoz. Të gjithë ju, të nderuar anëtarë të komisionit drejtues të rrjetit, e keni marrë raportin dhe keni një informacion shumë më të detajuar.

Kësisoj, fjala është për ju, për të adresuar pyetje, komente. Le të fillojmë me pyetjet.

Kush ka pyetje lidhur me raportin e depozituar dhe me prezantimin e bërë nga përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë? Nuk ka pyetje.

Kush ka diskutime, rekomandime apo sugjerime në lidhje me hartimin e raporteve për 6- mujorët e tjerë?

Para se ne ta miratojmë, meqë jemi komiteti përgjegjës për miratimin e këtij raporti, në vendimin që do t'i shkojë Kryetarit të Kuvendit, por edhe rrjetit, njëkohësisht edhe Komisionit të Ligjeve, ne duhet të bëjmë edhe rekomandimet përkatëse si mund të

përmirësohet puna për raportimin nga institucionet. Me të drejtë zonja Jaku ngriti disa shqetësime, të cilat kanë nevojë të adresohen, në varësi të problematikave të nxjerra në pah. Disa prej tyre mund të adresohen nga titullarët e ministrive, por ka prej tyre, të cilat kërkojnë një bashkërendim, punë dhe angazhim të të gjithë anëtarëve të rrjetit. Sikurse, nëse ka probleme të mosrespektimit të afateve të raportimit, ose mosraportim, ose cilësi të dobët të raportimit nga institucionet kushtetuese ose të pavarura, të cilat raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë, kjo mund të jetë një detyrë që mund t'i lihet komisionit parlamentar, i cili është përgjegjës, ose në fushën e juridiksionit të të cilit shtrihet aktiviteti i organit të pavarur, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë. Po ashtu, ka nevojë edhe për një bashkërendim më të mirë të aktiviteteve, veprimtarive midis institucioneve që janë pjesë e ekzekutivit, por edhe bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Në këtë kudër secili prej nesh mund të kontribuojë në funksionin apo detyrat që ka për të përmirësuar raportimin, i cili nuk është qëllim në vetvete, por mbi të gjithë për zbatimin e strategjisë dhe vënien në dispozicion për çdo qytetar.

Prandaj, unë do të vlerësoja shumë çdo sugjerim nga ana juaj për ta përmirësuar raportimin e institucionit, pse jo edhe për të forcuar kontrollin në lidhje me zbatimin e strategjisë dhe të planit të veprimit.

Kush dëshiron ta marrë fjalën?

Po, zonja Noçka.

**Eda Noçka** – Përshëndetje!

Unë, së pari, përgëzoj ministrinë e Drejtësisë për këtë punë të konsiderueshme voluminoze që ka bërë në një kohë të shkurtër, duke marrë në konsideratë që edhe plani i veprimit është miratuar në nëntor të vitit të kaluar, ku janë parë edhe problematikat që lidhen më raportimin dhe koordinimin e një sërë institucioneve për këtë raport.

**Vasilika Hysi** – Zonja Noçka, afrojeni pak mikrofonin, që të dëgjoheni më mirë!

**Eda Noçka** – Edhe sipas raportimit të ri të formatit “IPSIS” ne si organizatë e shoqërisë civile kemi pasur vështirësitë tona edhe të përshtaturit me formatin. Kemi pasur një komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Drejtësisë në këtë drejtim.

Sa i përket raportit të parë të monitorimit, unë personalisht mendoj që pavarësisht realizimit të pjesshëm të disa prej objektivave, ky raport paraqet një rezultat të kënaqshëm, duke marrë në konsideratë edhe të gjithë problematikat jo vetëm për sa i përket raportimit, por edhe të situatës së krijuar nga pandemia. Edhe ne si organizata, sa u përket jo vetëm aspekteve financiare, por edhe të zbatimit të aktiviteteve të edukimit ligjor publik dhe të informimit ku në thelb janë aktivitete terreni, për hir të situatës nuk kemi arritur të plotësojmë tërësisht planin



e punës apo të detyrimeve që rrjedhin nga organizatat në kuadër të zbatimit të planit të veprimit. Megjithatë, nga një lexim që i bëra raportit të monitorimit mendoj se, sa u përket shumë objektivave, ka rezultate të cilat janë të kënaqshme për kohën e shkurtër të raportimit dhe mendoj që të gjithë duhet të jemi të kënaqur në këtë drejtim.

Sa i përket publikimit apo edhe raportimit nga institucionet e organizatave, ashtu siç është parashikuar në strategjinë e edukimit ligjor të publikut, një nga detyrat edhe të komisionit drejtues (ne e kemi aplikuar këtë praktikë edhe vitin e kaluar) është t'u kërkojmë institucioneve më shumë angazhim dhe koordinim në drejtim të raportimit apo edhe hartimit të planit të veprimit.

Sa i përket mbledhjes së fundit të komisionit, një nga propozimet që do të paraqisja është që komisioni drejtues t'u drejtohet institucioneve në përfundim dhe pas miratimit të këtij raporti monitorimi, duke tërhequr masat e rekomandimit të tyre në një raportim brenda afateve, por edhe në një kombinim mes tyre.

Sa u përket organizatave të shoqërisë civile, pa diskutim që ne si qendra i kemi mbështetur në fazën e raportimit dhe natyrisht do t'u drejtohem apo do të koordinojmë punën me organizatat, me qëllim që të mos ketë vonesa nga organizata të shoqërisë civile ose të paktën ato organizata që janë të angazhuara drejtpërdrejtë në zbatimin e planit të veprimit të mos kenë as problematika në raportim, por edhe vonesa në përfundimin e raporteve.

Unë nuk kam komente të veçanta sa i përket raportit të monitorimit, pasi të gjitha problematikat dhe propozimet për përmirësimin e raportimit dhe hartimit të këtij plani janë paraqitur te Ministria e Drejtësisë.

I përgëzoj sërish për punën e bërë dhe personalisht jam dakord me përmbajtjen e këtij raporti!

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Noçka, për vlerësimin që i bëni raportit, si dhe për propozimet për ta përmirësuar nivelin e raportimit, jo vetëm në aspektin formal të respektimit të afateve të formës së raportimit, por edhe të asaj që është cilësuar me të drejtë! Edhe unë bashkohem me të.

Ne si komision drejtues i rrjetit kemi përgjegjësinë për të bërë një vlerësim jo vetëm sasior të përmbushjes ose jo të objektivave, plotësimit të kryerjes së aktiviteteve, por mbi të gjitha ka shumë rëndësi analiza cilësore, nëse strategjia e edukimit ligjor dhe plani i veprimit dhe aktivitetet e planifikuara i kanë adresuar problematikat dhe nevojat që kanë grupet e posaçme që ne kemi përmendur.

Në këtë kuadër do të doja të theksoja, të nderuar përfaqësues dhe anëtarë të këtij komisioni, se grupi, të cilit i adresohet kjo strategji, është shumë i gjerë, janë gratë, fëmijët, personat me aftësi të veçanta, janë minoritetet, personat, të cilët janë në vështirësi ekonomike, janë individë me probleme ekonomike-sociale, janë punëkërkuarit dhe në kuadër të pandemisë është ajo që thatë me të drejtë ju, zonja Noçka, aktivitetet janë në terren, por teknologjia na mundëson mundësinë e komunikimit për një kategori të caktuar shoqërore edhe nëpërmjet rrjeteve sociale dhe komunikimit, sikurse ne jemi sot, për pjesën tjetër të shoqërisë, e cila është më në nevojë për të marrë informimin dhe edukim. Patjetër që pandemia ka ndikuar dhe kjo është arsyeja që ne duhet të diskutojmë së bashku, ndoshta edhe në një takim të dytë që do të bëhet me bordin këshillimor, se si mundemi që në kushtet e pandemisë të ofrojmë edukimin ligjor dhe ta bëjmë sa më mirë dhe sa më të zbatueshëm strategjinë dhe planin e veprimit.

Në këtë kuadër çdo ide dhe sugjerim nga ana juaj për ta përmirësuar këtë proces do të ishte shumë i mirëpritur, pasi vlerësoj se kjo periudhë pandemie ka nevojë më shumë se çdo periudhë tjetër për informimin dhe edukimin e qytetarëve. Pandemia COVID-19 ka nxjerrë në pah nevojën për informacion në shumë fusha, të cilat për fatin e mirë, kjo është meritë e atij procesi gjithëpërfshirës të konsultimit, strategjia i ka parashikuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Faleminderit, zonja Noçka!

Ju lutem, kush dëshiron ta marrë fjalën?

**Erzen Tola** – Përhëndetje të gjithëve!

Unë jam Erzen Tola, përfaqësues i Ministrisë së Arsimit. Ne jo vetëm që jemi njohur me raportin, por kemi punuar gjerësisht me të, ku kemi pasur edhe diskutime shumë të zgjeruara me zonjën Janku, të cilën e falënderoj për mirëkuptimin, si dhe punën e mirë që ka bërë për raportin!

Ne kemi diskutuar rresht për rresht në lidhje me të gjitha ato që ka raportuar Ministria e Arsimit sa u takon masave. Parimisht e vlerësoj shumë raportin final të hartuar nga Ministria e Drejtësisë dhe ju falënderoj të gjithë!

Nuk kam asnjë vërejtje, të paktën për pjesën që ka raportuar Ministria e Arsimit në këtë raport.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Tola, për vlerësimet!

Kam besimin që ministria ku ju bëni pjesë, e cila është një nga aktorët kryesorë në informimin dhe edukimin ligjor të publikut, nëpërmjet edukimit të hershëm, do të vijojë të luajë një rol shumë të rëndësishëm në këtë informim.

Do ta mirëprisnim si komision, por edhe si Kuvend, që për vitin 2021 të kishim një aktivitet më të shtuar të informimit dhe të edukimit ligjor të nxënësve dhe të punës që duhet bërë nëpërmjet studentëve dhe klinikave ligjore të krijuara pranë një pjese të mirë të institucioneve të arsimit të lartë.

E mirëpres një rritje të veprimtarisë suaj në këtë periudhë për zbatimin e kësaj strategjie.

Kush dëshiron tjetër ta marrë fjalën?

Po, zonja Janku.

**Tatjana Janku** – Sikurse edhe ju e përmendët dua të falënderoj institucionet e pavarura kushtetuese, të cilat pavarësisht se nuk e kanë detyrim për të raportuar, na kanë sjellë një informacion se çfarë kanë zhvilluar gjatë vitit 2020 në drejtim të informimit të publikut Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ashtu edhe për Prokurorinë e Përgjithshme.

Ndjesë, nëse nuk i përmenda, por ato janë të pasqyruara edhe në raport!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Janku!

Jam dakord me vlerësimin që ju i bëtë, pasi edhe unë gjatë leximit të raportit konstatova që institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj kanë qenë korrekte, kanë raportuar dhe kanë dhënë informacion. Kjo është një mundësi shumë e mirë për njohjen e veprimtarisë së tyre dhe për të çuar sa më shumë informacion te grupet në nevojë që kanë nevojë të dinë e t'i njohin më mirë këto organe.

Të mos harrojmë që ky raport do të bëhet publik në faqen e Kuvendit. Ministria e Drejtësisë, ndërkohë, e ka bërë publik, si dhe të gjitha institucionet në linkun e tyre në faqen zyrtare, në kuadër të transparencës, do të ishte mirë ta botonin. Në këtë mënyrë ne do t'i inkurajonim të gjitha institucionet dhe aktorët e shoqërisë civile, pavarësisht nëse janë ose jo pjesë e rrjetit, për ta lexuar për të orientuar punën e tyre, për të shmangur çdo mbivendosje dhe për të plotësuar çdo vakuum ose mangësi, ose grupe të caktuara apo në zona të caktuara, ku ka nevojë për më shumë punë dhe edukim ligjor në terren.

Pikërisht një nga vlerat që ka ky raportim që, me të drejtë, e tha zonja Janku, është të njohim kush po punon dhe çfarë po bën, në cilat kategori shoqërore po punohet, ku janë më shumë nevojat dhe ku ka ende hapësira, të cilat janë të shumta, për të punuar të punohet.

Besoj se një nga rekomandimet do të ishte edhe për t'ua adresuar edhe donatorëve, për t'ua sjellë në vëmendje, që edhe ata në lidhje me mbështetjen që do t'u japin projekteve të kenë në konsideratë nevojën që ka përmbushja e objektivave të parashikuar në strategji dhe zbatimi i planit të veprimit. Mund të jetë një dokument udhërrëfyes, ndihmës. Absolutisht nuk

mund të jetë detyrues, por do të ishte një orientues shumë i mirë për të gjitha organizatat që janë donatore, qofshin këto vendase dhe ndërkombëtare.

Dëshiron njeri tjetër ta marrë fjalën?

Në këtë mbledhje ne kemi të ftuar edhe studentët që kryejnë stazhin pranë Kuvendit të Shqipërisë në kuadër të një projekti të PACEP që ne kemi dhe një element shumë i rëndësishëm i projektit, me mbështetjen e qeverisë zvicerane, është informimi dhe edukimi ligjor i të rinjve dhe rritja e kontakteve ndërmjet qytetarëve dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Në këtë kuadër, edhe ky takim është një mundësi informimi dhe sensibilizimi qoftë për studentët, qoftë edhe për publikun e gjerë, meqenëse mbledhja është duke u transmetuar në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në *Facebook*.

Pra, kushdo mund ta ndjekë, të marrë një informacion dhe, pse jo, të bazuar në këtë, të frymëzohet dhe të bëhet pjesë e rrjetit dhe e zbatimit të strategjisë.

Ndonjë mendim? Ndonjë sugjerim? Nuk keni? Mund të ndiheni...

Po, zonja Janku.

**Tatjana Janku** – Unë kisha një sugjerim, nëse ju do ta shikoni të arsyeshme, pasi siç e vutë re edhe në raport, në atë prezantim që bëra te konkluzionet dhe sfidat, te problematikat që kemi hasur, problemin e kemi me institucionet, të cilat duhet të përgjigjen edhe për institucionet e tyre të varësisë.

Problematikën më të madhe e kemi pasur me Ministrinë e Brendshme, e cila ka në varësi të saj edhe Agjencinë për Qeverisjen Vendore, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilat janë institucione që raportojnë, kanë masa konkrete, aktivitete konkrete. Por nuk e dimë si mund të veprojmë ndryshe, pasi shkresën ne ua kemi dërguar. Pikat e kontaktit ne i kemi dhe u kemi dërguar *e - mail* si të gjitha institucioneve të tjera. Ndoshta ata nuk janë koordinuar midis njëri-tjetrit, por ne nuk dimë ku të drejtohem për të mbledhur informacionin e plotë nga një institucion qendror, që mund të japë informacion edhe për institucionet në varësi.

E njëjta gjë ndodh edhe me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, e cila ka edhe punësimin dhe që ka goxha punë për të bërë në drejtim të edukimit ligjor të publikut. Edhe me këta, për të thënë të drejtën, pas një shkëmbimi goxha të madh *e - mail*-esh dhe bisedash telefonike nuk kemi pasur as raportim dhe asnjë reagim se kujt duhet t'i drejtohem për të marrë kontributin për raportimet e ardhshme. Nëse ju na ndihmoni në këtë drejtim, unë personalisht do t'ju isha mirënjohëse, për të ditur ku të drejtohem.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Janku!

Unë pajtohem me shqetësimin që ju keni adresuar, se ndihet edhe në raport pabarazia në ofrimin e informacionit. Nga ana tjetër, të gjithë jemi dëshmitarë që këto institucione kanë kryer një veprimtari aktive lidhur me edukimin ligjor, sidomos në nxitjen e punësimit apo programet. Për shembull, Policia e Shtetit, ka një sërë programesh që po zbaton me partnerët ndërkombëtarë dhe me Akademinë e Sigurisë.

Një nga rekomandimet ne mund ta bëjmë në raportin që do t'i përcillet Komisionit të Ligjeve dhe Kryetarit të Kuvendit, për më tepër që në komisione ka filluar raportimi i institucioneve të pavarura. Por nuk përjashtohet mundësia që çdo deputet apo edhe vetë drejtuesit e komisionit t'u adresojnë kërkesa dhe pyetje drejtuesve të ministrive përkatëse, për këto shqetësime që ju ngrini me të drejtë. Pa harruar këtu edhe rolin që kanë 61 bashkitë, pasi edukimi dhe formimi ligjor i publikut nuk është vetëm në nivelin e institucioneve qendrore, por shumë i rëndësishëm është komunikimi në nivel vendor. Organet e vetëqeverisjes vendore luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e informimit të qytetarëve, pasi edhe kontaktet që qytetarët kanë janë më të shpeshta dhe më të shumta me njësitë e vetëqeverisjes vendore sesa me organet qendrore.

Keni ndonjë mendim apo sugjerim tjetër?

Zoti Bajrami, a mund t'ju bëj një pyetje, ju lutem?

**Urim Bajrami** – Përshëndetje! Patjetër, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Pas leximit të detajuar të raportit të përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, shikohet që një pjesë e objektivave janë të përmbushura pjesërisht, sidomos ato që kanë të bëjnë me informimin e qytetarëve. Në kushtet e pandemisë media luan një rol shumë të rëndësishëm, duke përdorur të gjitha mekanizmat dhe këtu nuk flas vetëm për Televizionin Publik Shqiptar apo për radion, por për të gjitha mediet. Do të vlerësoja shumë një mendim nga ana juaj: në kushtet e pandemisë dhe kur komunikimi me prezencë fizike është më i kufizuar, madje në grupe edhe më të limituara, çfarë mund të merrnit apo të bënit më shumë si një autoritet ose çfarë do të na sugjeronit për të bërë një informim më të mirë nëpërmjet medias në lidhje me zbatimin e planit të veprimit dhe të strategjisë së edukimit ligjor?

Faleminderit!

**Urim Bajrami** – Faleminderit për pyetjen!

Një aktivitetet që ne kemi dhe e konsiderojmë goxha të rëndësishëm është kodi i transmetimit dhe njohja e publikut, e gazetarëve, e medias, organizatave të shoqërisë civile pikërisht me kodin e transmetimit për shërbimin mediatik audioviziv, por ndërkohë nga ana tjetër edhe të drejta që kanë qytetarët, në raport me kodin, por gjithashtu edhe me ligjin. Ne

kemi parashikuar një sërë aktivitete pikërisht për këtë, por duhet të kemi parasysh që kodi i transmetimit i është nënshtruar një përmirësimi në vitin 2017, përveç se është një detyrim ligjor parashikimi dhe përmirësimi i tij, ne po shikojmë trendin e ankesave që mbërrijnë pranë autoritet.

Pra, e thënë më shkurt edhe më qartë, zhvillimet dinamike të teknologjisë, sigurisht që ndikojnë edhe në përmirësimin e kodit të transmetimit, ky kod do t'i nënshtrohet një konsultimi të gjerë publik, sikurse është bërë edhe në vitin 2017, ndoshta një konsultim edhe më i gjerë që përfshin edhe redaksitë e televizioneve dhe të operatorëve në rrethe.

Ne kemi planifikuar ta shtrijmë këtë aktivitet edhe në rrethe, për një arsye shumë të thjeshtë, sepse nga një sondazh që kemi bërë, rezulton që ka munguar trajnimi i punonjësve të medias, po përdor punonjësit e medias për të përfshirë më shumë jo vetëm thjesht gazetarët, por edhe punonjës të tjerë që lidhen me media, u ka munguar trajnimi, pikërisht për kërkesat ligjore dhe për normat etike që parashikohen nga kodi i transmetimit, si akti ligjor më i rëndësishëm.

Nga ana tjetër, sigurisht që konsultimet do të jenë online, në varësi edhe të kushteve dhe të përmirësimit të situatës së pandemisë, por gjithashtu do të ketë edhe takime fizike, duke respektuar masat anti – COVID. Pra, po them, që nga ana tjetër ne po shikojmë mundësitë për të përfshirë organizata të ndryshme që kanë lidhje me median, por jo vetëm ato. Në disa projekte AMA po parashikon t'i bëjë në muajt në vijim, le të themi që pothuaj të gjithë projektet kanë lidhje, në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe në mënyrë të tërthortë, me edukimin ligjor të publikut.

Përpara se ta mbyll, sepse unë do ndërhyja në fund të këtij takimi, më lejoni të them diçka, kodi i transmetimit është një akt ligjor i rëndësishëm, por ajo që vëmë re, është se ka gjithmonë nevojë për përmirësim, si dhe vëmë re që ka edhe një mungesë informacioni rreth tij. Ne filluam 2 ose 3 vjet më përpara, ndoshta, për ta prezantuar variantin e përmirësuar të kodit të transmetimit, për ta prezantuar edhe në shumë universitete, në auditorët e studenteve, më së shumti te studentët e komunikimit, të gazetarisë dhe shkencave sociale.

Ajo që dua të them në fund fare, në një nga takimet e fundit apo disa takime më përpara, ka qenë një situatë dinamike kjo e raportit, u la që nga Ministria e Drejtësisë, sepse edhe ky projekt, e kam diskutuar shpesh edhe me zonjën Tatjana Janku, edhe ky modeli IPSIS-it ka proceset e veta.

Në një nga takimet e fundit ne vendosëm që Ministria e Drejtësisë të ofrohet, sigurisht në takime 5-10 minuta, me institucionet përkatëse për të diskutuar gjërat që nuk shkonin mirë ose nuk arrinin të kuptoheshin më qartë. Meqenëse ne do të kemi raportime të tjera për këtë

çështje, do të doja t'u riktheheshim edhe një herë atyre seancave. Ndoshta Ministria e Drejtësisë me një institucion, në varësi edhe të një grafiku që mund të bëhet, mund të jetë fleksibël, duke diskutuar me institucionet përgjegjëse. Pra, do t'u rikthehem këtyre seancave, sepse në të ardhmen do të kemi raportime dhe ndoshta do të vijojmë me problemet që kemi hasur deri tani.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Zoti Bajrami, faleminderit për informacionin dhe sugjerimet!

Është e vërtetë që, në bazë të strategjisë, institucionet do të kenë raporte 6-mujore. Për këtë vit kishim një raport 1-vjeçar, sepse edhe plani i veprimit u miratua në nëntor të vitit 2020. Më parë është punuar pa pasur një plan veprimi, por duke zbatuar aktivitete konkrete, sipas strategjisë. Tashmë që plani i veprimit është në fuqi, besoj se brenda muajit qershor Ministria e Drejtësisë duhet të raportojë në komisionin drejtues raportin 6-mujor. Kjo do të thotë se institucionet duhet të fillojnë të planifikojnë aktivitetet e tyre në kuadër të strategjisë dhe të raportojnë në mënyrë më cilësore se tani.

Gjithashtu, institucionet që nuk kanë raportuar ta bëjnë pjesë të punës së tyre raportimin në raportin e radhës periodik.

Unë i rikthehem shqetësimit, që me të drejtë ngriti zonja Janku.

Për sa u përket institucioneve që nuk kanë raportuar dhe kërkesës së zonjës Janku, për një mbështetje dhe angazhim të Kuvendit të Shqipërisë, do të thosha se Kuvendi i Shqipërisë do të përdorë mekanizmat institucionalë gjatë kësaj periudhe që është i mbledhur, sepse edhe ju e dini që do të shpërndahet për shkak të zgjedhjeve të përgjithshme. Të jeni të bindur se brenda kësaj jave ne do t'u japim një informacion komisioneve përkatëse, që kjo periudhë e shkurtër e veprimtarisë parlamentare të përdoret për të informuar dhe sensibilizuar drejtuesit e institucioneve dhe për t'i inkurajuar ata për të raportuar.

Për sa u përket institucioneve të pavarura, të cilat janë ose jo pjesë e rrjetit, kanë vijuar punën e tyre, ka filluar raportimi i tyre në komisione, kanë paraqitur raportet vjetore.

Ndërkohë, unë e gjej me vend adresimin e shqetësimit tuaj për bashkëpunim midis institucioneve dhe agjencive të varësisë. Në këtë kuadër, besoj se Kuvendi, por edhe vetë Ministria e Drejtësisë, sikurse e tha edhe zoti Bajrami, duke bërë komunikime direkt me personat e kontaktit, mund ta shtyjë këtë proces dhe jo vetëm kaq, por meqenëse Këshilli i Ministrave është një institucion shumë i rëndësishëm, pjesë e komisionit drejtues dhe vetë rrjetit, mund të shërbejë si një mekanizëm, si një institucion, i cili, nëpërmjet sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, në komunikim me sekretarët e përgjithshëm të ministrive, të adresojë këtë shqetësim. Pra, mekanizmat ose instrumentet ekzistojnë, qoftë në nivelin e pushtetit ekzekutiv, edhe në atë të kontrollit parlamentar.

Gjithashtu, nëse do të më lejoni, ju adresuat edhe problemin e mosraportimit në kohë mendoj se ky është një problem që mund të zgjidhet lehtësisht nëpërmjet një komunikimit që mund të bëni ju, zonja Jaku, ashtu siç e bëtë tani në këtë periudhë të ngjeshur të fundvitit, ku me gjithë skepticizmin nëse do ta përmbushnit ose jo objektivin, mund të them se e keni përmbushur objektivin dhe keni dorëzuar një raport, që unë e vlerësoj si një raport shumë të mirë, pasi është raporti i parë dhe nuk keni pasur ndonjë përvojë të mëparshme. Kjo tregon se, kur ka vullnet dhe besim te aftësitë dhe mundësitë tuaja, si dhe me të gjitha pikat e kontaktit me institucionet, gjithçka është e mundur të realizohet.

Lidhur me propozimin që ju bëtë për t'u dërguar një shkresë institucioneve që nuk kanë raportuar në kohë, ose që nuk kanë raportuar fare, unë do ta konsultoj këtë gjë edhe me bordin këshillimor. Unë besoj se do të mbledhim bordin këshillimor shumë shpejt këto ditë për të marrë edhe një opinion të tij dhe për t'ia komunikuar edhe rrjetit, si dhe për të pasur në mbledhje të rrjetit, meqenëse në fillim të vitit ne kemi detyrim të bëjmë një mbledhje të rrjetit. Në fakt, ky nuk është thjesht një detyrim, por unë mendoj, dhe e quaj shumë të domosdoshme, tashmë që rrjeti e ka marrë raportin, i kërkoj rrjetit për të na dhënë disa vlerësime lidhur me raportin, por edhe për të parë se ku janë vetë anëtarët e rrjetit në lidhje me raportin, me respektimin e afatit të raportimit, por edhe për të nxjerrë disa mësim nga raporti i parë, pse jo edhe për të paraqitur shqetësimet që mund të kenë hasur në lidhje me formatin në ri të raportimit, i cili është një sistem i ri dhe i vështirë. Në dijeninë time, edhe Kuvendi ka hasur vështirësi në zbatimin e atij formati, por besoj se raportimi i dytë do të jetë shumë më i mirë dhe do të kemi më shumë informacion dhe do të kemi më shumë aktorë të përfshirë.

Unë dua të adresoj një problem dhe do të doja mendimin tuaj në mbyllje të këtij takimi. Ne po bëjmë këtë mbledhje të komisionit drejtues dhe në dijeni është çdo qytetar që ndjek "RTSH Kuvend", *Facebook*-un e Kuvendit apo faqen zyrtare të Kuvendit, njëkohësisht do të ketë edhe njoftime në faqen e Kuvendit, si dhe në faqet tuaja, pra se si mundet që t'i përcjellim më tej gjetjet e këtij raporti në nivel vendor. Pra, për të pasur sa më shumë akses dhe informim të qytetarëve, pasi jo të gjithë janë aktualisht *online* duke na ndjekur ose janë në dijeni të strategjisë së planit të veprimit dhe të këtij raporti, që raporti në vetvete të mos jetë thjesht një përmbushje detyrimi në kuadër të strategjisë apo një përgatitje raporti për Kryetarin e Kuvendit apo për Komisionin e Ligjeve, por që të na shërbejë si një dokument bazë për të përmirësuar punën, për të ftuar dhe për të sensibilizuar të gjithë aktorët e tjerë të shoqërisë civile që veprojnë në Tiranë dhe jashtë saj, por edhe institucionet në nivel vendor.

Unë këtu do të doja një mendim nga të gjithë ju, të ftuar të nderuar, pse jo edhe nga studentët stazhierë se si mund ta përcjellim këtë informacion, në mënyrë që të inkurajojmë dhe



të nxisim të gjitha institucionet në nivel vendor për t'u angazhuar në objektiva konkrete dhe në aktivitete, pse jo edhe për të pasqyruar dhe për të bërë publike punën që ata bëjnë në nivel vendor. Unë kam bindjen se ka shumë veprimtari në nivel vendor, pavarësisht pandemisë, por ndoshta një pjesë e mirë e institucioneve në nivel vendor apo e personave nuk janë në dijeni të kësaj pune apo të këtij angazhimi që ka marrë Kuvendi i Shqipërisë apo institucionet, shoqëria civile në këtë bashkëpunim shumë të frytshëm.

Fjala është për ju për ndonjë mendim konkret, në mënyrë që t'ia përcjellim edhe komisionit.

Po, Eda.

**Eda Noçka** – Për sa u përket organizatave të shoqërisë civile, do të përcjellim një listë tatave, me të cilat ne bashkëpunojmë, raportin dhe gjetjen e raportit. Për organizatat në nivel vendor, ne do të bashkëpunojmë me organizatat që janë organizata në Tiranë, por që kanë koordinatorët e organizatave lokale në nivel vendor, me qëllim që të shpërndahen në mënyrë sa më të gjerë jo vetëm nëpërmjet komunikimit elektronik, por edhe nëpërmjet faqeve tona *web* apo rrjeteve sociale.

Për sa u përket organizatave, besoj se kjo është mënyra më e mirë e komunikimit. Ata kanë një komunikim shumë të mirë në nivel vendor, por edhe në organizatat vendore, me qytetarët, me grupet vulnerabël. Ndërkohë, për institucionet, besoj se Ministria e Brendshme mund të na ndihmojë në shpërndarjen e raportit, por edhe në sensibilizimin e njësisve të qeverisjes vendore jo vetëm për të raportuar, por edhe për të parashikuar në të ardhmen masën që mund të realizohen në nivel vendor.

Ne, si shoqëri civile, do të përdorim të gjitha rrjetet tona në nivel kombëtar dhe në nivel vendor për të shpërndarë raportin, për të qenë të angazhuar në zbatimin, por edhe në mbledhjen e informacionit për raportin 6-mujor.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Noçka!

A ka ndonjë ide tjetër? Nëse nuk ka diçka tjetër, në mbyllje, sipas strategjisë, ne kemi të drejtën dhe detyrimin jo vetëm ta diskutojmë raportin, por edhe ta miratojmë atë për t'ia përcjellë Kryetarit të Kuvendit dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Në këtë kuadër, në vendimin që bën komisioni drejtuesi i rrjetit, pasi miraton këtë raport, duhen vënë në dukje arritjet, mangësitë në zbatimin e planit të veprimit, si dhe rekomandimet e dhëna për institucionet zbatuese, si dhe propozon masa korigjuese, përmirësuese dhe plotësuese të planit të veprimit.

Unë kam një pyetje për Ivën, këshilltaren, ku dua të falënderoj këshilltarët e komisionit dhe sekretariatit të rrjetit, a mund të përgatisin një vendim të komisionit dhe ta

qarkullojnë midis anëtarëve? Ju lutem, në një kohë sa më të shkurtër të mundshme, nga marrja e projektvendimit, ta konsultoni dhe të jepni opinionet tuaja, me qëllim që t'ia përcjellim komisionit dhe Kryetarit të Kuvendit. Mos harroni që periodha është e shkurtër, për shkak të shpërndarjes së parlamentit për të kaluar në fushatën zgjedhore të 25 prillit. A është e mundur, Iva?

**Iva Seseri** - Po, e miratojmë dhe draftin e vendimit e qarkullojmë.

**Vasilika Hysi** - Ne biem dakord ta miratojmë si raport dhe për këtë ne duhet të votojmë.

Ju lutem, ata që kanë të drejtë për të votuar, të hapin kamerat dhe të votojnë!

Kush është dakord me raportin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë lidhur me zbatimin e planit të veprimit për periudhën janar-dhjetor 2020? Të gjithë dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Vendimin me rekomandimet përkatëse, ne do ta qarkullojmë. Njëkohësisht, do të kemi një mbledhje të bordit këshillimor dhe të rrjetit dhe ju jeni pjesë e tyre. Më lejoni që, në emrin tuaj, edhe një herë të falënderoj Ministrinë e Drejtësisë, në mënyrë të e veçantë zonjën Janku, dhe stafin që kanë punuar për koordinimin e punës dhe hartimin e këtij raporti. Nuk ka qenë një detyrë e lehtë. Absolutisht që është një detyrë e vështirë, ka qenë ushtrim për herë të parë, por unë kam besimin që raportet 6-mujore, që do të paraqiten, do të jenë shumë më të mira, më gjithëpërfshirëse, do të ketë më lehtësi dhe besoj se do të ketë një përgjigje më të mirë nga institucionet. Në përgjigje të shqetësimit tuaj, zonja Janku, dhe të rekomandimeve të bëra edhe nga anëtarët e tjerë të komisionit, ne do t'u dërgojmë një shkresë institucioneve, të cilat nuk kanë raportuar në kohë dhe do të adresojmë edhe shqetësimin, sugjerimin që ju patët për një bashkërendim më të mirë të punës midis ministrive dhe agjencive ligjzbatuese dhe në varësi të tyre. Besoj se rrjeti vetë dhe angazhimi që mori zonja Noçka, si anëtare e komisionit, do të mundësojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin midis shoqërisë civile. Zoti Bajrami, i cili përfaqëson një nga institucionet që mbulon media dhe monitoron median, do të ketë mundësi për ta inkurajuar median, së pari, për të njohur strategjinë për ta sensibilizuar, për ta informuar publikun për strategjitë dhe planin e veprimit. Besoj se në media do të ketë shumë vende dhe mundësi, sepse qytetarët duan të dinë për këtë mundësi dhe për angazhimet që mund të marrin institucionet, por edhe shoqëria civile. Unë kam merak organet e qeverisjes vendore, dhe këtu besoj nëpërmjet nënkomisionit për organet e vetëqeverisjes vendore do të inkurajojmë, ndoshta, duke u dërguar një letër kryetarëve të bashkive, për t'u përfshirë në këtë proces dhe

për të forcuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile në nivel vendor, sikurse me nënkomisionin për administratën publike ne mund t'i drejtohem edhe Shkollës së Administratës Publike për të nxitur dhe për të inkurajuar në të gjitha trajnimet që ofrojnë për punonjësit e shërbimit civil, ku janë pikërisht edhe këta persona që do të përgatisin dhe raportin ose ata që ne themi koordinatorët për të drejtën e informimit në nivel të institucioneve, me qëllim të informojnë dhe të përmbushin të gjitha detyrimet që lindin në kuadër të zbatimit të planit të veprimit. Nuk e di nëse lashë ndonjë çështje tjetër.

Dua t'i falënderoj institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj që, sinqerisht, janë model, që, pavarësisht se nuk kanë atë detyrimin të raportojnë, e kanë konsideruar këtë veprimtari si një detyrim jo thjesht ligjor, por moral dhe qytetar, një përgjegjshmëri dhe një llogaridhënie, deri diku, për përgjegjësitë që ato kanë në fushën e informimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve, sidomos organet e barazisë dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe AMA.

Faleminderit!

Ju uroj një pasdite të këndshme! Qëndroni të sigurt! Uroj që në takimin tjetër ju dhe familjarët tuaj të mos keni probleme me pandeminë dhe pasojat që ajo ka shkaktuar dhe po shkaktton.

Gjithët të mirat!

Faleminderit teknikës së IT-së, sepse gjithmonë i kemi në krye të punës dhe shpesh harrojmë t'u themi faleminderit për mundësinë e komunikimit *online!*

Faleminderit!

Gjithët të mirat!

**MBYLLET MBLEDHJA**